

Irida Sina Rrezarta Pllana

Teknologji e Informimit dhe Komunikimit

LIBËR PËR MËSUESIN

11

Irida Sina Rrezarta Pllana

Teknologji e Informimit dhe Komunikimit

LIBËR PËR MËSUESIN

11

ISBN: 978-9951-786-08-9



9 789951 786089

BOTIME



Irida Sina

Rrezarta Pllana

Libër për mësuesin

Teknologjia e informimit dhe Komunikimit

TIK 11

**(Gjimnazi i shkencave
shoqërore-gjuhësore)**

BOTIME



Prishtinë, 2019

BOTIME



Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Dr.sc. Azem KUCUYKU,
Prof. asoc. dr. Sabrije OSMANAJ
Arsie ALIQL, Valdet PLAKOLLI

Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-08-9

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, korrik 2019
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

;Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
;Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14
e-mail: marketing@botimepegi.al
;Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

HYRJE	5
II. Programi mësimor, kompetencat dhe kuptimi i tyre	7
III. Teknika të mësimdhënies	8
IV. Organizimi i procesit të mësimit	12
V. Materiale dhe burime mësimore	14
VI. Lidhja ndërlëndore	15
PLANI DYMUJOR: Shtator-tetor (2019-2020)	20
PLANI DYMUJOR: Nëntor-dhjetor (2019-2020)	22
PLANI DYMUJOR: Janar-shkurt (2019-2020)	24
PLANI DYMUJOR: Mars-prill (java 1) (2019-2020)	26
PLANI DYMUJOR: Prill-maj (2019-2020)	27
PLANI DYMUJOR: Qershor (2019-2020)	29

HYRJE

TIK-u dhe përdorimi i tij do t'i ndihmojë nxënësit që njohuritë dhe shkathtësitë e zhvilluara t'i transferojnë me sukses në mjedisin ku jetojnë dhe veprojnë. Ata do të mësojnë të përdorin TIK-un me kujdes, duke kuptuar mundësitë dhe kufizimet e tij, si dhe ndikimin tek individët, grupet dhe më gjerë. Nëpërmjet lëndës së TIK-ut, nxënësit do të njohin pajisjet e teknologjisë së informimit dhe të komunikimit, si dhe do të tregojnë guxim e iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për punë dhe për ndërlidhjen e shkathtësive personale me përvojën e tyre, edukimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, Qëllimet kryesore të lëndës së TIK-ut janë:

- Zhvillimi dhe thellimi i njohurive në lëminë e TIK-ut dhe rëndësia e saj në jetë dhe punë.
- Krijimi i shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, aftësive të kërkimit, analizimit dhe prezantimit të informacioneve nga fusha e TIK-ut.
- Formulatat, funksionet, grafikët dhe prezantimet me përdorimin e programeve aplikative kompjuterike, janë gjithashtu thelbësore në praktikën teknologjike për përcaktimin dhe sqarimin e ideve dhe zgjidhjeve të propozuara.
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë.
- Aftësimi për mësim gjatë tërë jetës.

Nëpërmjet TIK-ut, nxënësit krijojnë shprehje dhe shkathtësi gjatë punës teorike dhe praktike për kërkim të pavarur të informacioneve nga të gjitha fushat kurrikulare. Në klasën e njwmbwdhjetë, nxënësit gjithashtu do të zbatojnë analizimin e të dhënave, formulatat dhe funksionet, krijimin e prezantimeve, multimediat, duke demonstruar me raste konkrete. Lënda e TIK-ut ka një lidhje të veçantë me të gjitha fushat e Kornizës Kurrikulare e cila iu mundëson lëndëve avancimin dhe promovimin modern të tyre, përmes TIK-ut. Përdorimi i TIK-ut ndihmon në përvetësimin më të mirë të lëndëve tjera, duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më tërheqëse.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do të udhëheqë mësuesit në zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë, në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat edhe në kurrikulën e TIK-ut.

Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është orientimi i mësuesit/es që japin TIK-un në klasën e 11-të, për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule dhe zbatimin me sukses i saj kalon nëpër tri elemente mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit sipas formateve të reja;

b) zbatimin e metodologjinë e mësimdhënies, bazuar në teknika të mësimdhënies të cilat nxisin bashkëpunimin midis nxënësve;

c) realizimin e vlerësimit për të nxënë dhe i të nxënit.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së njwmbwdhjetë, përkatësisht shkalla e pestë e lëndës TIK, miratuar nga MASHT-i, në 2018.

Ky libër merr përsipër:

- **të sqarojë** çdo mësues/e të TIK-ut për të gjitha çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatohet në lëndën e tij/saj.
- **të udhëheqë** çdo mësues/e me formatet e planifikimit e kërkuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren në lëndën e TIK-ut, duke i udhëzuar ata mbi: **planifikimin vjetor, periudhave ditore, situatat e të nxënit, format e vlerësimit etj.**, me të cilat duhet të punojë gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim ofron modele ose i sugjeron, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim. Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

AUTORËT

II. Programi mësimor, kompetencat dhe kuptimi i tyre

Ky libër përshkruan në mënyrë të detajuar programin mësimor të Tik-ut, klasa e 11-të dhe udhëheq mësuesin/en për ndërtimin e kompetencave të lëndës së Tik-ut si dhe të kompetencave kyçe, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën. Kjo lëndë vazhdon të zhvillohet në arsimin e mesëm të lartë (AML), pikërisht në shkallën e pestë ose të gjashtë.


Kompetencat kyçe dhe Tik-u

Fjala kompetencë ka filluar të zbatohet tashmë në mjediset mësimore. Kompetencat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënës, duke dhënë qartë rolin që ato kanë në përdorimin dhe në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale, në të cilën zhvillohet njohuria. Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson nxënësit të bëhen të aftë dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës. Kompetencat kyçe janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë 6 kompetencat kyçe, duke ditur sesi t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit sipas formateve të përcaktuara.

Këto kompetenca ndërtohet dhe arrihen përgjatë shkallës duke ndërtuar përmes temave që një nxënës të zotërojë aftësinë:



Mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç njohurive të TIK-ut, të zhvillojë domosdoshmëri me nxënësit e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

III. Teknika të mësimdhënies

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë, e cila kërkon të japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxisë interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënit*. Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmëbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit, janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënit këto metoda.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor, duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura.

Për të siguruar përdorimin efektiv të TIK-ut mësuesit duhet:

- të planifikojnë përdorimin e TIK-ut nga ana e nxënësve në bashkëpunim me mësuesit e lëndëve të tjera;
- të planifikojnë saktë temat e reja, për të cilat mund të përdoret TIK-u jo vetëm si aftësi kryesore, por edhe si aftësi që ndihmon në arritjen e dijeve në lëndët e tjera;
- të jenë të sigurt se burimet e TIK-ut janë në dispozicion për mësimdhënien dhe mësinxënien;

Është e rëndësishme që kur bëhet planifikimi i përdorimit të TIK-ut për temat e reja, të sigurohemi më parë që nxënësit janë në gjendje ta përdorin atë.

PërdorimeTik-utsimjetnëorënemësimitmundtashohimnëdisarastesiçpoipërshkruajmëmëposhtë:
Një orë mësimi në laboratorin e kompjuterave

Në një laborator kompjuterash ku mësimi zhvillohet me ndihmën e teknologjisë, nxënësit rrinë para kompjuterave dhe zhvillojnë veprimtaritë e tyre individuale si: përdorimi i programeve të ndryshme, kërkimi në internet, shkrimi i letrave dhe dërgimi i tyre elektronikisht, punime apo detyra individuale apo bashkëpunim *online* mes nxënësish. Nëpërmjet kësaj metode realizohet mësimi individual, si dhe komunikimi *online*, apo korigjimi dhe zbatimi i projekteve kurrikulare online.

1. *Një orë mësimi në një klasë me disa kompjutera*

Në klasat me disa kompjutera mund të kryhen disa veprimtari. Në këto lloj klasash të organizuara në grupe me nga tre-katër nxënës, komunikimi mësues-nxënës realizohet më lirshëm mes tyre.

Ndryshe nga laboratori, nxënësit kanë mundësi të punojnë pa kompjuterin dhe ta përdorin atë vetëm kur u duhet ose nëse u duhet. Në këtë mjedis, teknologjia shërben si mjet për të zgjidhur llojet e të gjitha detyrave që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e portofolave personale. Në këto klasa, mësuesit mund t'u japin nxënësve detyra të cilat bëhen me ndihmën e kompjuterit, duke bashkëpunuar me shokët e klasës ose nëpërmjet shkëmbimeve *online*.


2. Një orë mësimi në klasa me një kompjuter

Në disa shkolla ka klasa të cilat janë të pajisura me një kompjuter. Edhe pse një kompjuter mund të duket i pamjaftueshëm për orën interaktive, zhvillimi i mësimi me një kompjuter ka disa përparësi:

- mësuesi/ja menaxhon veprimtarinë e nxënësve në çdo moment;
- mësuesi/ja kontrollon lehtësisht veprimtarinë e nxënësve duke i udhëzuar ato;
- teknologjia është në dispozicion në momentin e duhur;
- nxënësit mund të shohin njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë lirshëm;
- duke pasur vetëm një kompjuter në klasë, vëmendja zhvendoset nga teknologjia në mësim nëpërmjet bashkëpunimit.

Përdorimi i Tik-ut në mësim rrit cilësinë e mësimdhënies, paraqet një strategji mjaft të rëndësishme për asimilimin e njohurive dhe ofron mundësi për përmirësimin e sistemit arsimor.

Për këtë arsye, rekomandohet aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe nxënies duke integruar TIK-un në proces vetëm në orët kur shikohet e arsyeshme. Për të realizuar, orë të tilla nevojiten këto pajisje:



Në këto cikle shkollimi është shumë e rëndësishme t'i jepet rendësi faktit që jo të gjithë nxënësit mësojnë njësoj dhe nuk kanë të njëjtat nevoja.

Brainstorming (Stuhi mendimesh)

Brainstorming (stuhi mendimesh) është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të mendojnë rreth një çështjeje dhe të diskutojnë rreth saj me synim ndërtimin e njohurive të reja. Kjo teknikë siguron një mjedis të lirë dhe të hapur, që inkurajon të gjithë pjesëmarrësit për të shprehur në mënyrë kreative mendimet e tyre rreth një problemi. Teknika (brainstorming) përdoret në fazën fillestare të ndërtimit të njohurive të reja. Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rendisin të gjithë njohuritë, që ata kanë lidhur me temën e re. Në këtë fazë, roli i mësuesit/es është të drejtojë debatin, të kuptojë mendimet e nxënësve dhe të dëgjojë me kujdes idetë e tyre. Përdorimi i kësaj teknike synon pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor. Brainstorming është një teknikë e thjeshtë dhe e efektshme, e cila kërkon një nivel të lartë krijimtarije për t'u përdorur. Këtë teknikë, mësuesit e TIK-ut mund ta përdorin gjatë kohës që zhvillojnë kryesisht tematikën e Internetit si dhe atë të prezantimit digjital. Gjithashtu, mësuesit, gjatë tematikës së prezantimit Digjital, mund t'u kërkojnë nxënësve të realizojnë prezantime duke përdorur programe të ndryshme multimediale, dhe më pas t'u kërkojnë nxënësve nga ndryshojnë ato nga njëri-tjetri.

Harta e koncepteve (Konceptograma)

Harta e koncepteve (Konceptograma) është një metodë (teknikë) e paraqitjes vizuale të një informacioni, dhe shërben për lidhjen e koncepteve të një teme mësimore, disa temave apo të një tematike. Përcaktimi me saktësi i kësaj metode (teknike) mundëson qëndrueshmëri ***në përvetësimin e njohurive, integrimin logjik dhe aftësinë për zbatimin e tyre, si dhe shprehinë e një pune krijuese.*** ***Konceptograma shërben si*** një instrument diagnostikues i procesit të të nxënësve interaktiv. Konceptogramën mund ta ndërtojmë edhe duke filluar nga një koncept specifik dhe të kalojmë te koncepti themelor. Ata mund të jenë dyllorësh: të thjeshta ose të detajuara në degë hierarkike. Elementët përbërës të tyre janë: etiketat, vijat dhe nyjat.


Në etiketa vendosen konceptet, vijat lidhin konceptet dhe përcaktojnë tipin e strukturës së konceptogramës.

Konceptograma zbatohet lehtë në kushtet e mjedisit të një klase. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit hap pas hapi duke mbajtur shënime në tabelë, dhe pasi dëgjon mendimet e tyre, bën vërejtjet përkatëse dhe ndërton një konceptogramë, duke u bazuar në idetë më të mira të nxënësve. Më poshtë po rendisim veprimet që kryen mësuesi/ja gjatë një ore mësimore:

- Mësuesi/ja rendit në një tabelë përmes diskutimit me nxënësit të gjitha konceptet që përmban tema apo tematika.
- Ai ndërton së bashku me nxënësit diagramin e konceptogramës duke vendosur konceptet në etiketa.
- Vendos konceptin më të përgjithshëm në qendër dhe e rrethon atë.
- Pyet nxënësit se cilat janë konceptet e tjera, që lidhen me konceptin e vendosur tek etiketa qendrore.

- Bashkon etiketat me vija të thjeshta ose vija me shigjeta sipas kontekstit të përmbajtjes së tyre.
- Mësuesi/ja mund edhe të udhëzojë nxënësit, që ata të ndarë në grupe të ndërtojnë secili nga një konceptogramë. Në fund të kohës së caktuar, mësuesi/ja kontrollon konceptogramet, dhe ndërton një konceptogramë duke debatuar dhe bërë komentet e duhura me nxënësit për problematikat ose logjikën e ndjekur nga ana e tyre.

Në lëndën e TIK-ut, nxënësit e klasës së 10-të deri në klasën 11-të mund të krijojnë lehtësisht hartat e koncepteve nëpërmjet programit Prezi, ose nëpërmjet programeve dhe aplikacioneve të specializuara siç është p.sh.: MindView.



Projekte kërkimore

Projekti kërkimor është vlerësuar si metodë tepër pretenduese, realizimi i së cilës kërkon praktikimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: intervista, vrojtimi, studimi rasti, dhe pse jo, edhe kombinimin e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Për të realizuar këtë teknikë, mësuesi/ja duhet t'u lërë nxënësve në dispozicion disa orë mësimore. Kjo teknikë mund t'u propozohet nxënësve për realizimin e një projekti lëndor, të cilit mësuesit mund t'i lërë në dispozicion disa orë të tre-mujorit. Nuk duhet që orët të realizohen në klasë, ato mund të jepen në formën e detyrave të shtëpisë. P.sh.: kur nxënësit kanë për të trajtuar **temën e kërkimit në Internet ose editimi i dokumenteve online**, ata mund të marrin në Intervistë nxënësit më të rritur, prindërit apo edhe mësuesit. Më pas, të analizojnë të dhënat që do të dalin nga intervistat, dhe më pas duke i diskutuar në klasë të shohin se sa këto të dhëna përputhen me njohuritë lëndore.

Udhëzime për përdorimin e saj:

- Kërkohet të shfrytëzohet informacioni dhe njohuritë e nxënësit nga më shumë se një lëndë.
- Është metodë që vë në përdorim dhe shfrytëzon përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e tyre të marra nga burime jo shkollore.
- Si metodë kërkon që shumë nga veprimtaritë e nxënësve të kryhen jashtë orës së mësimi dhe jashtë mureve të shkollës.

- Projekti kërkimor kërkon përcaktimin e partnerëve pjesëmarrës në arritjen e objektivave. Partnerët mund të jenë mësues/e të lëndëve të tjera, prindër dhe përfaqësues të komunitetit.

Të mësuarit me projekte (Projekti)

Projekti kurrikular është strategji e të nxënës dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin, përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti, si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.

Projekti kurrikular në lëndën e TIK-ut, është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënës.

- Zbatimi i një projekti në lëndën e TIK-ut kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tria periudhat, por mund të jetë i shtrirë edhe vetëm brenda një periudhe. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi/ja që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi/ja vlerëson nxënësit përgjatë zhvillimit të tij.
- Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:
 - përcaktimi saktë i çështjes ose problemit për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë;
 - përcaktimi qartë i detyrave që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënësi;
 - grumbullimi i materialit dhe/ose mjeteve të nevojshme;
 - përpunimi, analizimi dhe redaktimi i të dhënave të grumbulluara;
 - nxjerrja e përfundimeve nga të dhënat e grumbulluara;
 - përgatitja e produktit përfundimtar;
 - prezantimi i projektit ose i produktit të krijuar.

IV. Organizimi i procesit të mësimt

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënës të TIK-ut është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimt do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete krijuese, ku kërkohet përdorimi i TIK-ut për të zgjidhur situata konkrete nga jeta e përditshme. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe temave përkatëse mësimore. Mësimdhënia e TIK-ut, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Mësimdhënia e TIK-ut, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet:

- në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca;
- mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Ashtu siç e shpjeguam në kapitullin më sipër, nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës sesi ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e TIK-ut mban parasysh:

- ndërtimin e kompetencave kryesore të të nxënës në TIK;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin aftësive dhe shprehive për zgjidhje problemore dhe zhvillimin e mendimit kritik duke përdorur TIK-un;
- zbatimin e veprimtarive krijuese/interpretuese/vlerësuese, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet lëndore me situata të jetës reale;
- përdorimin e mjeteve didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, printer, video-projektor etj..;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënë që në procesin mësimor, mësuesi/ja dhe nxënësi të jenë plotësues të njëri-tjetrit.

Një planifikim i mirë krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit. Çdo model i planifikimit ditor është sugjerues, sepse kërkon të nxisë dhe orientojë mësuesit rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin orës mësimore, dhe për këtë arsye vendosja e rezultateve të të nxënës për zhvillimin e kompetencave kyçe nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues/e zgjedh të zhvillojë sipas këtij modeli të sugjeruar, por mund të zhvillojë këtë situatë ose të zhvillojë temën mësimore në një situatë tipike për klasën e tij. Ato kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve përmes njohurive që ata kanë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësit të punojnë me situata dhe veprimtari reale që ata i njohin, ku i kërkojnë arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si:

- “Pse shërben TIK-U në jetën e përditshme?”
- “A ndihmon TIK-u në përmirësimin e aftësive tona, për të zhvilluar kompetenca që kërkon tregu i punës?”
- “Cilat janë programet, *software* të mi të preferuar, që jam kurioz për t’i zhvilluar?”
- “Jam kurioz të njoh dhe zhvilloj aftësi që lidhen me multimedien dhe kërkimin në Internet?”

Në këtë mënyrë, ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja në kontekste të caktuara. Detyrat përmbledhëse, projektet individuale dhe në grup, kërkimet mbi çështje të ndryshme, gjykimet dhe qëndrimet personale janë një tjetër mënyrë që i krijojnë nxënësit mundësinë të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë që zotëron, si dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera. Prezantimet e punimeve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave të TIK-ut sidomos në kapitujt 2, 3, 5,6 dhe 8.

V. Materiale dhe burime mësimore

Për realizim më të suksesshëm të lëndës së TIK-ut duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, internet, softuerë arsimore, projekte, të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune.

Mësimdhënësit mund të krijojnë portofola, apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme, përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Mjetet audiovizive si: video, video-projektor, kompjuter, internet, USB, CD.
- Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe për të demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për TIK-un. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.
- Mjedisi mësimor (klasa, kabinetet e Informatikës etj.)

VI. Lidhja ndërlëndore

Fushat kurrikulare	Shembujt konkret se si lidhet TIK me lëndët
Artet	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Nxënësit hyjnë në një faqe web-i që publikon video si p.sh.: <i>You Tube</i> (www.youtube.com). Vendosin 5 video kërcimi në një listë dhe vlerësojnë çdo kërcim duke vendosur yje. Reagojnë me komente të përshtatshme kritike për çdo klip. Planifikojnë një kërcim në grup. Nën kujdesin e mësuesit kryejnë dhe ngarkojnë kërcimin. Diskutojnë komentet e marra me kalimin e kohës për të përmirësuar performancën në të ardhmen. ✓ Viziton një studio virtuale muzikore p.sh. BBC OneMusic (www.bbc.co.uk/radio1/onemusic/studio/). Bën muzikë në një sekuenciator. Shqyrton punime të ndryshme në industrinë e muzikës. ✓ Të bëjë një reklamë për një seri të re produktesh imagjinare që promovojnë mjedis TIK të sigurt, të shëndetshëm dhe komod. Në grupe krijojnë modele të produkteve të paraqitura, një tingull dhe video reklamë. Shikimi i reklamave të prodhuara nga grupet e tjera. Shqyrtojnë kritikën e ndërsjella të reklamave për të rritur aftësitë e tyre që të bindin konsumatorin që të blejë produktet.
Gjuhët dhe komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Zgjedhin një temë me interes. Kërkojnë në <i>Wikipedia</i> artikuj që kanë lidhje me temën (www.wikipedia.org/). Zgjedhin disa nga informacionet dhe në mënyrë kritike analizojnë ato. Vlerësojnë faktet e paraqitura dhe komentojnë në lidhje me saktësinë, paragjykimin apo autoritetin e tyre. Redaktojnë artikullin e wikipedia-s nëse kërkohet. Diskutojnë pro dhe kundër ndërtimit të bashkësisë së njohurive.
Shoqëria dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Shfletojnë artikuj shëndetësorë në faqe me përmbajtje sociale ku informohen me të reja e fundit dhe më të njohura të shëndetit. Regjistrohen si përdorues dhe votojnë artikullin e tyre më të preferuar për shëndetin. Diskutojnë pikëpamjet e tyre rreth artikujve me nxënësit e tjerë të klasës. ✓ Hartojnë një projekt për mbledhjen e informacionit rreth nxënësve me sjellje të mirë në mjediset <i>online</i>. Studiojnë një grup. Prezantojnë të dhënat e mbledhura. Arsyetojnë mbi të dhënat për të identifikuar dhe rekomanduar objektivat e përmirësimit të grupit. ✓ Zhvillojnë disa njoftime në gazetën ose në website-in e shkollës për të njoftuar prindërit për krimin kompjuterik dhe përshkruajnë hapat që ata duhet të marrin për të mbrojtur veten dhe familjarët. ✓ Hulumtojnë viruset e aparateve telefonike celulare dhe shkruajnë një ese ku përshkruajnë llojet e viruseve mobile aktuale. Shpjegojnë se si ju mund të mbron përmes pajisjes tuaj celulare.

Matematikë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Eksplorojnë mjete <i>online</i> (www.explorellearning.com/) për të përdorur simulimet <i>online</i> për pyetjet matematikore. ✓ Hulumtojnë dhe krahasojnë rritjen e faqeve të rrjeteve sociale të ndryshme. Paraqesin një tabelë <i>excel</i> (spreadsheet) për të ilustruar krahasimin e rritjes. <p>Kurrikula e lëndës së TIK-ut jep kontekstin brenda të cilit mund të zbatohet dhe mund të zhvillohet të kuptuarit matematikor, rrjedhshmëria, arsyetimi logjik, mendimi analitik dhe aftësitë e problem-zgjidhjes. Në lëndën e TIK-ut, nxënësit përpunojnë të dhënat duke përdorur tabela, lista, piktura grafike, kolona grafike dhe vija grafike. Në matematikë, aftësitë e nxënësve për analizë të dhënash do të zhvillohen për të përfshirë pilotime të shpërndara, grafikë linearë dhe gradientët e grafikëve. Në studimin e matematikës, nxënësi/ja përdor programin <i>Excel</i> për të hedhur të dhëna matematikore, ata mund ta realizojnë nëpërmjet vizatimit të grafikëve, të cilët mund të shërbejnë më pas edhe për të realizuar analizën e të dhënave. Krijimi i një baze të dhënash ku të hedhim të dhënat për nxënësit: emër, mbiemër, ditëlindja, vendlindja etj. Kjo bazë të dhënash mund të përdoret më pas për përlllogaritje formulash kur nxënësit të kenë përvetësuar <i>Excel</i>-in.</p>
Shkencat natyrore	<p>Në kapitullin e dytë dhe të tretë nëpërmjet TIK-ut, nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Kryejnë një projekt mjedisor me temë të caktuar p.sh.: "Ndotja dhe mjedisi". Përdorin burimet digjitale të ndryshme për realizimin dhe prezantimin e tij. ✓ Rekomandojnë një zgjidhje për transferimin, ruajtjen, paraqitjen dhe arritjet e një projekti të përfunduar shkencor. Konsiderojnë harddrive-rin, pajisjet e dorës dhe zgjidhjet <i>online</i>. Cila zgjidhje siguron magazinim të sigurt, rikthim të lehtë për ndarjen, përshkrimin e përmbajtjes, datën e krijuar dhe përdorimin minimal të hapësirës. ✓ Krijojnë produkte digjitale me imazhe dhe tekst që tregojnë marrëdhënien midis shkencave kompjuterike dhe ndërveprimit. Përshkruajnë se si ndërveprimi nxit inovacionin dhe rrit produktivitetin. ✓ TIK-u mbështetet te konceptet e biologjisë, kimisë, fizikës për të zgjidhur problemet dhe skicon zgjidhje për të përmbushur nevojat dhe mundësitë njerëzore. Lidhjet me kurrikulën e shkencave të natyrës lejojnë zbatimet e koncepteve shkencore përmes kritikës dhe zbatimit të njohurive parësore për të projektuar zgjidhje të botës reale që janë të kuptueshme për nxënësit. P.sh., nxënësit zbatojnë njohuritë mbi forcat dhe karakteristikat e vetive të materialeve.

	<p>✓ TIK-u jep shumë teknika dhe teknologji për të automatizuar mbledhjen, magazinimin dhe analizën e të dhënave shkencore. Zhvillimi i teknologjive digjitale si: <i>data loggers, spreadsheets, databases, teknologjitë e simulimit dhe të imagjinatës</i> kanë qenë boshti për përparimin në shkenca. Ata janë përdorur për të mbledhur dhe për të organizuar një gamë të gjerë të dhënash dhe për të tërhequr informacion duke filtruar, analizuar dhe vizualizuar volume të mëdha të dhënash numerike, kategorike dhe strukturore, nëpërmjet programit të Excel që nxënësit e zhvillojnë në kapitullin e I-rë të librit.</p>
--	---

PLANI VJETOR – 2019/2020

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: XI

Lëndët e fushës kurrikulare L	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve						Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator-Tetor	Nëntor- Dhjetor	Janar- Shkurt	Mars-Prill (java I)	Prill-Maj	Qershor	
Lënda: TIK	1 .Interneti (1.1 – 1.7)	4. Përdorimi i sigurtë i internetit (4.1 – 4.4)	7. Shfrytëzimi i aplikacionit – baza e të dhënave (7.1 – 7.7)	7. Shfrytëzimi i aplikacionit – baza e të dhënave (7.8 – 7.16)	8. Karriera ime (8.1 – 8.5) Përsëritje	9. E - tregu (9.6) 10.Ndikimi i teknologjisë në shëndetin e njeriut (10.1 – 10.4)	TEMA 1 I.5, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9 TEMA 2 I.8, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9 TEMA 3 I.5, I.8, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9
	2. Navigimi në internet (2.1 – 2.4)	Përsëritje 5. Komunikimi nëpërmjet internetit (5.1 – 5.2)				Përsëritje	

Lënda: TIK	3. Kërkimi i informacioneve në internet (3.1 – 3.5)	6. Komunikimi elektronik (6.1 – 6.3)	Përsëritje		9. E - tregu (9.1 – 9.5)	<p>TEMA 4 I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9</p> <p>TEMA 5 I.4, I.5, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9</p> <p>TEMA 6 I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9</p> <p>TEMA 7 I.4, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9</p> <p>TEMA 8 I1, I3, II1, III2, III3, III5, IV1, IV3, V1</p> <p>TEMA 9 I1, I3, II1, III2, III3, III5, IV1, V1</p> <p>TEMA 10 I3, I5, I9, III6, III8, VI5, VI9</p>
------------	---	--------------------------------------	------------	--	--------------------------	--

PLANI DYMUJOR: SHTATOR – TETOR (2019-2020)

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna Lënda mësimore: TIK Klasa: XI

Tema mësimore: 1. Interneti 2. Navigimi në Internet 3. Kërkimi i informacioneve në internet

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: **Tema 1** (I.5, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9), **Tema 2** (I.8, I.9, II.2, III.3, III.4, III.6, VI.9), **Tema 3** (I.5, I.8, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9).

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: Tema 1, 2 dhe 3 (1.1, 1.2, 2.1, 4.1, 4.2, 8.1, 9.1)

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
1. Interneti	<p>-mëson mënyrën e komunikimit të kompjuterave në internet dhe lidhjet mes tyre;</p> <p>- njëh elementet e rrjetit.</p> <p>-shpjegon mënyrën e komunikimit të kompjuterave në internet dhe lidhjen mes tyre;</p> <p>- njëh llojet e rrjeteve dhe klasifikimin e tyre.</p>	<p>1.1 Rrjeti kompjuterik</p> <p>1.2 Llojet e rrjeteve</p> <p>1.3 Topologjia e rrjeteve</p> <p>1.4 Kanalet e komunikimit</p> <p>1.5 Interneti</p> <p>1.6 Lidhja me internetin</p> <p>1.7 Përparësitë dhe mangësitë e internetit</p>	16	<p>Parashikimi i njohurive:</p> <p>Parashikimi me tema paraprakë Ndërtimi i njohurive:</p> <p>Diskutim i përbashkët</p> <p>Përfundimi i të nxënësve: (Përmes pyetjeve)</p> <p>Punë praktike kohe reale</p>	<p>Vlerësimi me listë kontrolli</p> <p>Lista e kontrollit</p> <p>Testimi</p> <p>Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale</p> <p>Kompjuterike</p> <p>Kontributi dhe aktiviteti i tyre individual dhe në grupe</p>	<p>Gjuhë angleze, Matematikë Praktike profesionale</p>	<p>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësve, fletoret e nxënësve, materiale nga interneti, materiale plotësuese</p> <p>Teksti i nxënësve Fletoret e nxënësve</p>

2. Navigimi në Internet	<ul style="list-style-type: none"> Demonstron shkathësi në përdorimin e shërbimeve të internetit. Hulumton tema të ndryshme nëpërmjet makinave kërkuese në internet, si dhe tregon për mundësitë që ofron një browser. 	2.1 Shërbimet e internetit 2.2 Shërbimet e web-it 2.3 Organizimi i faqeve web 2.4 Të dhënat e koduara në internet		Hulumtim me kompjuter Metoda interaktive / ndërvepruese/ gjithëpërfshirëse Rrjeti i diskutimit Punë e drejtuar për të pasuruar portofolin e të nxënit. Tabela e konceptit/veprimtari e drejtuar/provo veten. Harta e mendimit/konceptograma Bashkëbisedim dhe ilustrim ose prezantim Rrjeti i diskutimit/vëzhgo analizodiskuto/praktikë e pavarur	Vlerësimi me shkrim Vlerësimi me gojë Vlerësimi me anë të dëgjimit Vlerësimi praktik	Materiale nga interneti Materiale plotësuese
3. Kërkimi i informacioneve në internet	<ul style="list-style-type: none"> Demonstron plotësimin e formularëve elektronik duke dhënë informacione rreth rëndësisë së tyre për secilën fushë të formularit. Dallon anët pozitive dhe negative të internetit duke marrë parasysh zhvillimin e tyre personal. 	3.1 Strategjitë e detajuara të kërkimit në web 3.2 Të dhënat në internet 3.3 Ngarkimi dhe shkakimi i të dhënave 3.4 Përpunimi i tekstit online nëpërmjet platformës Google 3.5 Përsëritje				

PLANI DYMUJOR: Nëntor-Dhjetor (2019-2020)

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore:** TIK Klasa: XI

Tema mësimore: 4. Përdorimi i sigurt i Internetit 5. Komunikimi nëpërmjet Internetit 6. Komunikimi elektronik

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjellimit të temës/ave: **Tema 4** (I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9), **Tema 5** (I.4, I.5, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9), **Tema 6** (I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9).

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjellimit të temës/ave: Tema 4,5 dhe 6 (I.1, I.2, 2.1, 4.1, 4.2, 8.1, 9.1)

Tema mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore orë mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
4. Përdorimi i sigurt i Internetit	<ul style="list-style-type: none"> Demonstron plotësimin e formularëve elektronik duke dhënë informacione rreth rëndësisë së tyre për secilën fushë të formularit. Dallonanët pozitive dhe negative të internetit marrë parasysh zhvillimin e tyre personal. Identifikon viruset e ndryshëm në internet duke pasur parasysh rrezikun e tyre dhe jep zgjidhje për mbrojtjen e të dhënave nga viruset. 	4.1 Malware-t dhe mënyrat e mbrojtjes prej tyre 4.2 Siguria në rrjetet dhe kriptografia 4.3 Nënshkrimi digjital 4.4 Krijimi i një linje nënshkrimi në Word apo Excel 5.1 Formularët elektronikë 5.2 Krijimi i pyetësorëve online dhe analizimi i rezultateve të tyre	12	Parashikimi i njohuriave: Parashikimi i kimi me terma paraprakë Ndërtimi i njohuriave: Diskutim i përbashkët Përfundimi i të nxënësve: Rishikim në dyshe	Vlerësimi me listë kontrolli Testimi Vlerësimi i detyrave dhe projekteve individuale kompjuterike Kontributi dhe aktiviteti i tyre individual dhe në grupe	Gjuhë shqipe Shkencat e natyrës Praktikë profesionale	Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materi-ale mësimore: teksti i nxënësit, fletoret e nxënësve, materiale nga interneti, materiale plotësuese. Teksti i nxënësit Fletoret e nxënësve

Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4. 2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: 6.1 Komunikimi elektronik				
Fjalët kyçe: Kodi Morse, Komunikimi elektronik, Telefon, Faks, Email, Forume, Rrjete sociale.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja: – aplikon mundësitë e reja që ofron komunikimi elektronik duke përdorur teknologji informative të ndryshme dhe aplikacione të ndryshme, në krijimin e mesazheve, menaxhimin e tyre dhe në shkëmbimin me të tjerët.				
Kriteret e suksesit: Çka është komunikimi elektronik? Çka është kodi Morse? Cili është funksioni i rrjeteve sociale?				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore				
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë: Mësuesi/ja inicion aktivitetin e mëposhtëm: Sipas studimit të vitit 2016 në botë regjistrohen rreth 205 miliardë email-e të dërguara në ditë dhe një sasi e konsiderueshme të dhënash, që shkarkohen nga rreth 1 miliard faqe web-i.				

Imagjinoni se sa kohë do të merrnin këto shërbime, nëse do të kryheshin nëpërmjet postës tradicionale. Diskutoni në klasë rreth mënyrave të komunikimit elektronik dhe jo elektronik, si dhe përparësitë dhe mangësitë e tyre.

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët:

Mësuesi/ja fillon diskutimin në lidhje me aktivitetin e mësipërm. Pastaj, vazhdon me shpjegimin e formave të komunikimit elektronik.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe:

Nxënësit/et fillojnë aktivitetin e mëposhtëm:

Në kapitullin e dytë keni mësuar rreth shërbimeve të internetit, ku një nga llojet e shërbimeve është dhe ai i komunikimit. Përmendni disa nga këto lloje shërbimesh dhe diskutoni përparësitë e secilit prej tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Përmes vlerësimit për të nxënit (Listës së kontrollit), mësuesi i ndihmon nxënësit /et që të gjejnë llojet e shërbimeve dhe diskutojnë përparësitë e tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data:
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: Komunikimi elektronik		Rezultati i të nxënit të temës Njeh mind-mapping-un dhe krijimin e hartave konceptuale apo skemave online.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4. 2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Planifikimi nëpërmjet Mind-mapping-ut			
Fjalët kyçe: Template, mind mapping, Design, Export, Format, nyje, sirtarë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – njeh mind-mapping-un dhe krijimin e hartave konceptuale apo skemave online.			
Kriteret e suksesit: Çka është <i>mind mapping</i> ? Krijimi i suksesshëm i projektit Mind View.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuele (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë: Mësuesi/ja prezanton aktivitetin e mëposhtëm: Çfarë programesh apo <i>software-sh</i> përdorni ju për të krijuar projektet mësimore apo për të prezantuar idetë tuaja risi?			

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët:

Mësuesi/ja fillon diskutimin në lidhje me aktivitetin e mëposhtëm dhe shpjegon për planifikimin nëpërmjet mind mappingut.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe:

Nxënësit/et praktikojnë punën me mind view.

Vlerësimi i nxënësve

Mësuesi/ja vlerëson krijimin e suksesshëm të mind mapping.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: Shfrytëzimi i aplikacionit – baza e të dhënave		Rezultati i të nxënit të temës Kupton rëndësinë e bazave të të dhënave. Mëson për konceptet kryesore të bazave të të dhënave. Mëson për objektet me rëndësi për funksionim të bazave të të dhënave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4. 2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Bazat e të dhënave			
Fjalët kyçe: Të dhëna, Baza e të dhënave, Sistemi për menaxhimin e bazave të të dhënave, Tabela, Rekordit, Fusha, Kërkesa, Forma, Raporti			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– kupton rëndësinë e bazave të të dhënave;– mëson për konceptet kryesore të bazave të të dhënave;– mëson për objektet kryesore të bazave të të dhënave.			
Kriteret e suksesit: Cilat janë objektet kryesore të aplikacionit <i>Ms Access</i> ? Cili është dallimi në mes të bazave të të dhënave dhe sistemit të bazave të të dhënave? Cila është rëndësia e përdorimit të aplikacionit MS Access në menaxhimin e bazave?			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			

Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprake:

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et që të hulumtojnë në internet për konceptet e bazave të të dhënave, respektivisht për:

1. Karakteristikat kryesore të tyre
2. Historiku i zhvillimit të Bazave të të dhënave
3. Përdorimet në jetën e përditshme

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët:

Mësuesi/ja tregon për konceptet themelore të bazave të të dhënave, si dhe për dallimin në mes të bazave të të dhënave dhe sistemit për menaxhim të bazave të të dhënave. Pastaj, mësuesi/ja tregon cilat janë sistemet për menaxhim të bazave të të dhënave, si dhe për objektet kryesore të *MS Access*. Mësuesi/ja prezanton në *MS Access* objektet e *MS Access*.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe:

Nxënësit/et hulumtojnë në internet për konceptin e bazave të të dhënave dhe sistemit për menaxhim të bazave të të dhënave dhe renditin disa tipe të bazave të të dhënave të disponueshme në botën e kompjuterit.

Vlerësimi i nxënësve

Përmes vlerësimit për të nxënit (Listës së kontrollit), mësuesi/ja i ndihmon nxënësit në kuptimin e koncepteve themelore të aplikacionit *MS Access*.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: Shfrytëzimi i aplikacionit – baza e të dhënave		Rezultati i të nxënit të temës: Kupton rëndësinë e <i>MS Access</i> në menaxhimin e bazave të të dhënave. Mëson për veglat e <i>MS Access</i> . Mëson për krijimin e bazave të të dhënave në <i>MS Access</i> .	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4. 2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Njohja me programin <i>MS Access</i>			
Fjalët kyçe: Të dhëna, Baza e të dhënave, Sistemi për menaxhimin e bazave të të dhënave, Tabela, Rekord, Fusha, Kërkesa, Forma, Raporti, <i>MS Access</i>			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– kupton rëndësinë e <i>MS Access</i> në menaxhimin e bazave të të dhënave;– mëson për veglat e <i>MS Access</i>;– mëson për krijimin e bazave të të dhënave në <i>MS Access</i>. Kriteret e suksesit: Përse shërben <i>MS Access</i> ? Cilat janë veglat e aplikacionit <i>Ms Access</i> ? Si krijohet dhe ruhet një bazë e të dhënave në <i>MS Access</i> ?			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			

Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraparakë

Mësuesi/ja pyet nxënësit për aplikacionet e paketës *MS Office*. Pastaj, mësuesi/ja hap diskutim për funksionalitetin e aplikacioneve të *MS Office*.

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët:

Mësuesi/ja prezanton përmes *MS Access* veglat e *MS Access* si dhe krijon një bazë të të dhënave dhe e ruan atë. Theks të veçantë i kushtohet formatit të *file*-it që ruhet baza e të dhënave në *MS Access*.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe:

Nxënësit/et praktikojnë punën me *MS Access*, duke hapur aplikacionin dhe duke u familjarizuar me veglat dhe *template* të *MS Access*.

Vlerësimi i nxënësve

Mësuesi/ja hap diskutim për tabelat në *MS Excel* dhe ato në *MS Access* dhe pyet nxënësit për dallimin në mes të këtyre aplikacioneve. Diskutimi hapet në gjithë klasën.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: Karriera ime		Rezultati i të nxënit të temës Identifikon qëllimet personale për jetë. Kupton rëndësinë e planveprimit personal. Përpilon planveprimin personal.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I1, I3, II1, III2, III3, III5, IV1, IV3, V1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme 4.2. Demonstron shkathësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: 8.1 Planveprimi im personal			
Fjalët kyçe: Qëllimet personale, karriera, strategjia, planveprimi personal			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – identifikon qëllimet personale; – kupton rëndësinë e planveprimit personal; – përpilon planveprimin personal. Kriteret e suksesit: A keni përpiluar planveprimin personal? Cilat janë sfidat e përpilimit të planveprimit personal? Cilat janë fazat qëllimit personal?			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë Mësuesi/ja i pyet nxënësit për qëllimin që kanë në tri vitet e ardhshme. Diskutimi me shokun/shoqen zgjerohet në gjithë klasën.			

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja shpjegon për qëllimet personale, si dhe për fazat dhe sfidat për identifikimin e qëllimeve personale.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe

Nxënësit/et hulumtojnë në internet për konceptin e bazave të të dhënave dhe sistemit për menaxhim të bazave të të dhënave dhe listojnë disa tipe të bazave të dhënave të disponueshme në botën e kompjuterit.

Vlerësimi i nxënësve

Përmes vlerësimit për të nxënit (Listës së kontrollit), mësuesi/ndihmësi/ja i ndihmon nxënësit në përpilimin e planveprimit të tyre personal.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: Karriera ime		Rezultati i të nxënit të temës Përkujton llojet e shkathtësive. Përkujton kërkesat e profesionit në treg. Përforcon konceptet për shkathtësi për punë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I1, I3, II1, III2, III3, III5, IV1, IV3, V1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4.2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: 8.2 Shkathtësitë dhe kërkesat e profesionit			
Fjalët kyçe: Profesioni, Komunikimi, Kreativiteti, Lidershipi, Shkathtësi, Karrierë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përkujton llojet e shkathtësive;– përkujton kërkesat e profesionit në treg;– përforcon konceptet për shkathtësi për punë. Kriteret e suksesit: Cilat janë shkathtësitë e nevojshme për profesione. Si fitohen shkathtësitë? Si zhvillohen shkathtësitë?			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë Mësuesi/ja i pyet nxënësit për profesionin që ëndërrojnë dhe cilat janë shkathtësitë që ata i kanë të forta për profesionin e caktuar.			

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja shpjegon për shkathtësitë e nevojshme për profesione duke elaboruar në shkathtësitë e nevojshme për tregun në Kosovë.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe

Mësuesi/ja pyet nxënësit/et si mendojnë t'i zhvillojnë shkathtësitë për punë.

Vlerësimi i nxënësve

Mësuesi/ja hap diskutim për shkathtësitë që duhet të zhvillohen për punë si dhe pyet nxënësit për formën e avancimit në këto shkathtësi.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: E tregu		Rezultati i të nxënit të temës Mëson për konceptet themelore të biznesit elektronik. Kupton përparësinë e shfrytëzimit të internetit për ndërmarrje. Kupton përparësinë e shfrytëzimit të internetit për konsumatorë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I1, I3, II1, III2, III3, III5, IV1, V1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4.2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Koncepte themelore të biznesit elektronik			
Fjalët kyçe: Biznesi, automatizimi, teknologjia, Interneti, WWW, Tregu elektronik, Marketingu Elektronik, Prokurimi Elektronik			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– mëson për konceptet themelore të biznesit elektronik;– kupton përparësinë e shfrytëzimit të internetit për ndërmarrje;– kupton përparësinë e shfrytëzimit të internetit për konsumatorë.			
Kriteret e suksesit: Ç'ka është biznesi elektronik? Cilat janë përparësitë e shfrytëzimit të internetit për ndërmarrje? Cilat janë përparësitë e shfrytëzimit të internetit për konsumatorë?			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë: Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et nëse mund ta mendojnë ndonjë shitore pa asnjë punëtor dhe diskutimi hapet në gjithë klasën për të diskutuar idetë e nxënësve/eve.			

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja shpjegon për konceptet themelore të biznesit elektronik dhe për rëndësinë e shfrytëzimit të internetit për ndërmarrje dhe konsumatorë.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe

Nxënësit/et hulumtojnë në internet për ndërmarrjet që operojnë në qytetin e tyre dhe identifikojnë portalet e këtyre ndërmarrjeve.

Vlerësimi i nxënësve

Përmes vlerësimit për të nxënit (Listës së kontrollit), mësime ndihmon nxënësit në hulumtimin në internet për portalin e ndërmarrjes, shërbimet e ndërmarrjeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: E tregu		Rezultati i të nxënit të temës Njoftohet me konceptin e tregtisë elektronike. Mëson për historikun e zhvillimit të tregtisë elektronike. Mëson për përkufizimet për tregtinë elektronike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I1, I3, II1, III2, III3, III5, IV1, V1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4.2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Përkufizimi dhe historiku i tregtisë elektronike			
Fjalët kyçe: Tregtia elektronike, Biznesi, konsumatorët, Interneti			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– njoftohet me konceptin e tregtisë elektronike;– mëson për historikun e zhvillimit të tregtisë elektronike;– mëson për përkufizimet për tregtinë elektronike. Kriteret e suksesit: Kur i ka fillet e veta tregtia elektronike? Kur ka filluar përdorimi masiv i tregtisë elektronike? Cilat janë disa nga përkufizimet për tregtinë elektronike?			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audiovizuale (videoprojektori)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et nëse e kanë më të lehtë të lexojnë një libër të shtypur apo elektronik. Diskutimi hapet në gjithë klasën. Nxënësit/et japin ide për identifikimin e sfidave të blerjes online.			

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja shpjegon për fillet e tregtisë elektronike si dhe për hovin e zhvillimit të tregtisë elektronike. Pastaj, mësuesi/ja jep një shembull të ciklit të tregtisë elektronike, si dhe prezanton disa nga përkufizimet në lidhje me tregtinë elektronike.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe:

Nxënësit hulumtojnë në internet për kompaninë lidere në fushën e tregtisë elektronike. Pastaj, nxënësit/et hulumtojnë për bizneset në qytetin e tyre që shfrytëzojnë tregtinë elektronike.

Vlerësimi i nxënësve

Mësuesi/ja hap diskutim për identifikimin e kompanive lidere në shfrytëzimin e tregtisë elektronike si dhe për kompanitë që shfrytëzojnë konceptin e tregtisë elektronike në qytetin e tyre.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____	
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK	Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI	
Tema: Ndikimi i teknologjisë në shëndetin e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës Analizojnë ndikimin e pajisjeve të teknologjisë informative në shëndetin e njeriut.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4. 2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: 10.1 Ndikimet pozitive të teknologjisë informative te njeriu				
Fjalët kyçe: Chatbot, kompjuter, komunikim, telefon, konferenca virtuale, mesazhe, komunikim elektronik, inovacion, Cloud, Whatsup, Viber, Digjitalizim, Telemjekësi				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – analizon ndikimin e pajisjeve të teknologjisë informative në shëndetin e njeriut.				
Kriteret e suksesit Si ka ndikuar pozitivisht ndikimi i teknologjisë në zhvillimin e biznesit? Si ka ndikuar zhvillimi i teknologjisë në komunikim? Çfarë është Cloud? Si ruhen të dhënat në Cloud? Si ka ndikuar zhvillimi i teknologjisë në edukim?				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audio-vizuale (videoprojektori)				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore				
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë Mësuesi/ja inicion aktivitetin e mëposhtëm: Që prej viteve 1990 janë zhvilluar hapat e parë të operacioneve kirurgjikale me asistencën e robotëve. Prej vitit 2000, një nga sistemet më të njohura kirurgjikale që vepron me ndihmën e robotikës është sistemi i ashtuquajtur Da Vinci. Ai përbëhet nga një robot me 3 ose 4 krahë të				

lidhur me një ekran (figura 1). Kirurgu vepron mbi pacientin duke qenë i ulur para ekranit dhe duke komanduar krahët e robotit. Ky sistem është miratuar nga Institucionet përkatëse që të kryejë vetëm disa tipe operacionesh, konsideruar si me rrezikshmëri të ulët. Disa nga arsyet pse kirurgët mund të përfitojnë nga këto sisteme janë: shikueshmëri më e mirë, saktësi më e lartë, eliminim i dridhjeve të dorës, dhe lëvizjet në drejtime që nuk mund të kryhen nga dora e njeriut, kjo për shkak të shkallës së rrotullimit prej 540 gradësh të kyçeve të robotit.

A njihni ju aplikime të tjera të makinerive ose teknologjisë së informacionit në mjekësi?

Po në jetën e përditshme, cilat janë disa nga mënyrat se si teknologjia e informacionit ju ka ndihmuar për detyrat tuaja.

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët:

Mësuesi/ja fillon diskutimin në lidhje me aktivitetin e mësipërm. Pastaj, vazhdon me shpjegimin e ndikimit të zhvillimit të teknologjisë në të bërit biznes.

Përforcimi i të nxënit: Rishikim në dyshe:

Nxënësit/et hulumtojnë në internet për ndikimin e zhvillimit të teknologjisë në biznes, edukim dhe mjekësi.

Vlerësimi i nxënësve

Përmes vlerësimit për të nxënit (Listës së kontrollit), mësuesi i ndihmon nxënësit/et që të dallojnë disa nga përparësitë në të bërit biznes, në edukim dhe në mjekësi.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			Data: _____	
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	Lënda: TIK		Shkalla e kurrikulës: V	Klasa: XI
Tema: Ndikimi i teknologjisë në shëndetin e njeriut			Rezultati i të nxënit të temës Analizojnë ndikimin e pajisjeve të teknologjisë informative te njeriu.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.9, II.2, III.2, III.3, III.4, III.6, VI.9				
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. 4.2. Demonstron shkathtësi në përdorimin e aplikacioneve dhe ueb shërbimeve.				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: 10.2 Kujdesi ndaj përdorimit të teknologjisë informative nga njeriu				
Fjalët kyçe: Blerje onilne, privatësia, llogaria e kreditit, varësia, dëmtimi i syve, rrezatime elektromagnetike, konsum i lartë i energjisë				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – analizon ndikimin e pajisjeve të teknologjisë informative te njeriu.				
Kriteret e suksesit Çfarë kuptojmë me ruajtjen e pavarësisë dhe sigurisë së të dhënave? Si duhet të kemi kujdes nga vjedhja e kartelës së kreditit? Si ndikon teknologjia në shëndetin e njeriut? Si ndikon teknologjia në mjedis?				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti shkollor, kompjuteri, materiale nga interneti, mjete audio-vizuale (videoprojektori)				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Matematikë, Gjuhë angleze dhe praktikë profesionale				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore				
Parashikimi i njohurive: Parashikimi me terma paraprakë: Mësuesi/ja prezanton aktivitetin e mëposhtëm: Revolucioni industrial, i cili daton në shekullin 18-19, ishte një periudhë në histori që përcaktoi tranzicionin nga prodhimi manual në prodhimin përmes makinerive. Në atë kohë, shumë vende pune u zhdukën dhe ato u zëvendësuan nga të tjera lloje punësh, që u krijuan duke iu përshtatur zhvillimeve të industrisë.				

Studiuesit pretendojnë se diçka e ngjashme po ndodh në ditët e sotme, kur revolucioni i teknologjisë së informacionit përbërë nga inteligjenca artificiale dhe interneti, po zëvendëson punën e njerëzve me punën e kompjuterëve ose robotëve.

Duke iu referuar faqes së internetit www.willrobotstakemyjob.com, e cila shfaq përqindjen e mundësisë që një profesion i kërkuar nga përdoruesi të zhduket për shkak të teknologjisë informative, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.



- Cilat janë punët me rrezikun më të lartë për t'u zëvendësuar nga robotët?
- Cilat janë llojet e profesioneve me më pak rrezik zëvendësimi?
- Provoni të kërkonit për një profesion që ju dëshironi të ndiqni në të ardhmen. Sa është përqindja e mundësisë për t'u zhdukur si lloj pune?
- Diskutoni mbi përparësitë dhe problematikat që mund të sjellë revolucioni teknologjik.

Ndërtimi i njohurive: Diskutim i përbashkët

Mësuesi/ja fillon diskutimin në lidhje me aktivitetin e mëposhtëm dhe shpjegon për ndikimin e teknologjisë në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Gjithashtu, mësuesi/ja shpjegon për format e vjedhjes së kartelës së kreditit dhe jep shembuj si mund të mbrohemi nga këto vjedhje.

Përforcimi i të nxënit: Punë në grupe

Ndahuni në klasë në dy grupe dhe njëri nga grupet të kërkojë dhe parashtrojë argumente pro papunësisë për shkak të zhvillimit teknologjik dhe grupi tjetër të parashtrojë argumentet kundër. Cilat janë disa nga mënyrat që propozohen për të reduktuar pasojat negative dhe për të bashkëjetuar me papunësinë për shkak të zhvillimit të teknologjisë së informacionit?

Vlerësimi i nxënësve

Mësuesi/ja hap diskutim në lidhje me pyetjet e mësipërme dhe hap diskutimin në gjithë klasën.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet nga libri i nxënësit, pjesa Provo Vetën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Hapat e një projekti kurrikular me shtrirje përgjatë 6 muajve.

Realizimi i një projekti kurrikular nëpërmjet metodës së Projektit kërkimor

Faza 1. Parapërgatitja për projektin: Tema: Përdorimi i Multimedias, për zhvillimin e karrierës

Paraqitet projekti që do të ndërmerret: Do të realizohen aktivitete që do të ndikojnë në përdorimin e Multimedias, si dhe prezantime dhe punime për të zhvilluar karrierën, biznesin dhe e-tregun.

Caktohet koha gjatë së cilës do të realizohet projekti p.sh.: Projekti do të realizohet nga Shtatori-Mars. Nxënësi do të marrë vlerësimin për secilin tremujor.

Kërkohet formulimi i saktë i njohurive që do të arrihen nga nxënësit. Njohuritë në këtë fazë janë tepër ambicioze. Ato prekin jo vetëm objektivat në nivelin e njohurive, por në nivelin e analizës, të sintezës, të zbatimit, të vlerësimit. Njohuritë e formuluarat dhe detyrat mësimore që do të arrihen në fund të projektit, duhen t'u bëhen të qarta nxënësve që në fillim dhe të sigurohemi për qartësinë e detyrës.

- Krijimi i video-tutorialeve duke përdorur Multimedian.
- Realizimi i posterave duke përdorur Multimedian.
- Realizimi i 30 intervistave me fëmijët e moshave nga 16-18 vjeç, se çdo të thotë për ta Internet i Sigurt, Mjedis i Pastër etj...

Kërkohet që nxënësi/ja të përcaktojë partnerët që do të bashkëpunojë në këtë projekt kërkimor. Ata mund të jenë: mësues, nxënës të klasave paralele, prindër, përfaqësues të bashkësisë etj. Atyre duhet t'u bëhet e qartë detyra mësimore që do të realizohet bashkërisht, si dhe kur do të realizohet përfshirja e tyre.

- Nxënësit mund të bashkëpunojnë me nxënësit më të rritur, për të realizuar intervistat.
- Mund të kërkohet ndihma e prindërve për incizimin e intervistave, të kërkohet informacion *online* se sa i njohin bashkëmoshatarët rregullat për zhvillimin e karrierës ose biznesin online, apo informacion rreth temës që kanë zgjedhur për të zhvilluar në Projekt.
- Mund të bashkëpunohet me televizione për të bërë një emision të shkurtër. Përcaktohen teknikat dhe mjetet që do të përdoren në funksion të projektit.
- Kasetofon për incizimin e intervistave.
- Internet, dhe kompjuter për realizimin e posterave dhe gjetjen e informacionit.
- Fleta me ngjyra ose artikuj revistat që japin informacione rreth temës. Paracaktohen produktet e projektit.
- Workshop që nxisin të rinjtë për të gjetur punë apo për të bashkëpunuar me kompani biznesi online.

- 3 Video-Tutoriale.
- Analizë grafike e dalë nga intervistat.

Faza 2. Puna rreth projektit

- Grupet e nxënësve zbatojnë detyrat e përcaktuara nga mësuesi/ja për të realizuar dhe përfunduar detyrën mësimore.
- Formulohen pyetësorët e përgatitur qëllimisht për të grumbulluar informacionin e kërkuar në funksion të detyrës mësimore (pyetësorët mund të përgatiten nga mësuesi/ja në ciklin e ulët ose nga nxënësit në shkollën e mesme).
- Plotësohen pyetësorët dhe përmbledhen të dhënat.
- Zhvillohen intervistat e caktuara paraprakisht dhe dokumentohen ato në kasetofon nëse ka mundësi.
- Fiksohen vërtetimet e bëra nga nxënësit. Ato mund të jenë cikël fotografish të bëra nga nxënësit ku fiksohen pamje të cilat sjellin informacion rreth projektit, shënime të mbajtura nga nxënësit, ku të jetë e pranishme data, vendi, problemi.
- Grumbullohen materialet e siguruar nga intervistat, pyetësorët vërtetimet dhe nxirren përfundimet.
- Sistemojnë të dhënat dhe fillon faza e përgatitjes për ta bërë të njohur përfundimin e projektit kërkimor në prani të një publiku në shkallë më të gjerë.

Faza 3. Vlerësimi

Bëhet vlerësimi i punës ku përmbledhen pikat kryesore, renditen faktet e paraqitura, tregohet çfarë është e realizuar, si është bashkëpunuar me partnerët dhe kush janë përfitimet, produktet apo gjetjet në këtë projekt. Duhet që secili nga nxënësit të marrë vlerësimin sipas angazhimit që ai ka bërë për realizimin e projektit, dhe mësuesi/ja të ketë ndarë paraprakisht të gjitha detyrat që duhet të realizojë secili nga nxënësit.

Mësuesi/ja në tremujorin e parë vlerëson se sa ka përdorur saktë nxënësi/ja komandat e programit që ka zgjedhur për të realizuar videot. Vlerëson saktësinë e realizimit të intervistave si dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet programeve multimediale p.sh. harta grafike, për të analizuar dhe prezantuar të dhënat në mënyrë grafike.

Në tremujorin e dytë do të vlerësojë përfshirjen e nxënësve për të prezantuar punimet, saktësinë për të folur para një audience të caktuar, si dhe qartësinë e informacionit të përzgjedhur

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

7.016:004(072)(075.3)

Sina, Irida

Libër për mësuesin : teknologji e informimit dhe komunikimit 11 : (gjimnazi i shkencave shoqërore-gjuhësore) / Irida Sina, Rrezarta Pllana. - Prishtinë : Botime Pegi, 2019. - 68 f. : me il. ; 20.7x28 cm.

1. Pllana, Rrezarta

ISBN 978-9951-786-08-9

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë, nr. 312/01-B, të datës 16.07.2019.